INSTITUTI I STUDIMEVE PËR KRIMET
DHE PASOJAT E KOMUNIZMIT
Nr. 235/1 Prot.
Tiranë, më 9/11/2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STUDIMEVE PËR KRIMET DHE PASOJAT E KOMUNIZMIT
DREJTORIA E STUDIMEVE

Nr. 235/1 prot.

Tiranë më 9/11/2026

Lënda: Thirrje për artikuj në revistën "Memoria" nr. 13-14, 2028

Revista "Memoria" është botim studimor-shkencor i Institutit për Studimin e Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit që synon të mbushë një boshllëk në fushën e studimit të krimeve të komunizmit, duke shfrytëzuar mundësitë që ofron zhanri i artikujve shkencorë: trajtimin e më shumë temave në një kohë më të shkurtër, duke angazhuar sa më shumë studiues, brenda dhe jashtë ISKK. Revista studimore "Memoria" është e hapur për studiues me eksperiencë dhe të rinj, mjafton që artikulli të trajtojë lëndën në mënyrë objektive dhe në parametrat shkencorë të domosdoshëm.

Redaksia e revistës "Memoria" mirëpret shkrimet tuaja për numrin 13-14, 2028.

Afati i dorëzimit të tyre është data 31 mars 2027.

Thirrje për artikuj në revistën "Memoria" nr. 13-14, 2028

Ju bëjmë me dije se, struktura e artikullit shkencor do të jetë si më poshtë:

Emri, mbiemri i autorit, me madhësi shkrimi (font size) 12.

Titulli i artikullit (bold), me madhësi shkrimi (font size 14).

Abstrakti i artikullit, me madhësi shkrimi (font size) 12.

Fjalët-kyçe, me madhësi shkrimi (font size) 12.

Artikulli mund të ndahet në çështje sipas problemeve që trajton autori.
Lloji i shkrimit do të jetë (Times New Roman), me madhësi (font size)
12.

Titulli i përmbledhjes së artikullit në gjuhën angleze (bold), me madhësi shkrimi (font size) 12.

Përmbledhje e artikullit në gjuhën angleze me madhësi shkrimi (font size 11).

Artikujt shkencorë do t'i paraqiten redaksisë sipas këtyre kritereve:

– Artikulli shkencor nuk duhet të jetë më i gjatë se 8000 fjalë dhe jo më i shkurtër se 3000 fjalë, së bashku me të gjitha shtesat (abstraktin, fjalët-kyçe, përmbledhjen e artikullit, tabela, grafikë, foto etj.).
– Abstrakti i artikullit duhet të përfshijë deri në 1.000 karaktere, me madhësi shkrimi (font size) 12. Abstrakti duhet të paraqesë në mënyrë shumë të përmbledhur, problemet ose çështjet kryesore që synoni të trajtoni në artikullin shkencor, me qëllim që të ndihmoni lexuesin që të fokusohet tek ato.
– Fjalët-kyçe do të jenë deri në 10 fjalë, me madhësi shkrimi (font size) 12.
– Të gjithë fjalët ose titujt e publikimeve në artikull ose në referencat e tij që shkruhen me alfabete të ndryshme nga ai latin, si: alfabeti cirilik, osmanisht, greqisht, etj., duhet që të transkriptohen përbri fjalës/fjalisë, titullit etj., në variantin me shkrim latin.
Ju kujtojmë se redaksia e revistës nuk do të pranojë artikuj shkencorë që nuk plotësojnë kriteret e mësipërme.
Jeni të lutur që shkrimet tuaja për revistën, t'i dërgoni në adresën elektronike: info@iskk.gov.al

Citimet dhe bibliografia sipas Chicago style:

Citimi i librave

Emër Mbiemër, Titulli (Vendi i botimit: Shtëpia e botuese, viti), faqja.

Citimi i shkurtuar kur përsëritet gjatë të njëjtit artikull

Mbiemri, Tituli i shkurtuar, faqja.

Citimi tek bibliografia në fund të artikullit

Mbiemër, Emër, dhe Mbiemër, Emër. Titulli. Vendi: Shtëpia e botuese, viti.

Mbiemër, Emër. Titulli. Vendi: Shtëpia e botuese, viti.

Citimi në librat me editim

Citimi i një kapitulli në libër me editim

Emër Mbiemër, "Titulli i kapitullit", në Titulli i librit, red. Emër Mbiemër i autorit editues (Vendi i botimit: Shtëpia e botuese, viti), faqja.

Citimi i shkurtuar

Mbiemër, "Titulli i kapitullit i shkurtuar", faqja.

Në bibliografi

Mbiemër, Emër. "Titulli i kapitullit". Në Titulli i librit . redaktuar nga Emër Mbiemër i autorit editues, f. X-XX. Vendi i botimit: Shtëpia e botuese, viti.

Citimi i një libri me editim në tërësi (kur nuk specifikohet ndonjë nga artikujt e tij)

Emër Mbiemër, red., Titulli (Vendi i botimit: Shtëpia e botuese, viti), faqja.

Citimi i shkurtuar

Mbiemri, Tituli i shkurtuar, faqja.

Në bibliografi

Mbiemër, Emër, red. Titulli. Vendi: Shtëpia e botuese, viti.

Citimi i artikujve nga revistat shkencore

Emër Mbiemër, "Titulli i artikullit", Titulli i revistës, nr. (Muaji, viti): faqja.

Citimi i shkurtuar

Mbiemër, "Titulli i artikullit i shkurtuar", faqja.

Në bibliografi

Mbiemër, Emër. "Titulli i artikullit", Titulli i revistës, nr. (Muaji, viti): f. X-XX.

Citimi i artikujve nga revistat shkencore me disa autorë

Emër Mbiemër et al., "Titulli i artikullit", Titulli i revistës, nr. (Muaji, viti): faqja.

Citimi i shkurtuar

Mbiemër et al., "Titulli i artikullit i shkurtuar", faqja.

Në bibliografi

Mbiemër, Emër, Emër Mbiemër dhe Emër Mbiemër. "Titulli i artikullit", Titulli i revistës, nr. (Muaji, viti): f. X-XX.

Citimi nga artikujt e shtypit

1. Emër Mbiemër, "Titulli i artikullit", Titulli i gazetës, 17 prill 2017, 43.

Në bibliografi

Mbiemër, Emër. "Titulli i artikullit", Titulli i gazetës, 17 prill 2017, 43.

Citimi i disertacioneve

Emër Mbiemër, "Titulli i disertacionit" (Disertacion., Universiteti X, viti), faqja.

Citimi i shkurtuar

Mbiemri, "Tituli i shkurtuar", faqja.

Në bibliografi

Mbiemër, Emër. "Titulli i disertacionit". Disertacion., Universiteti X, viti.

Citimet nga webi

"Privacy Policy," Privacy & Terms, Google, Tërhequr më 17 prill 2017.

https://www.google.com/policies/privacy/.

Citimi i shkurtuar

Google, "Privacy Policy."

Në bibliografi

Google, "Privacy Policy", Privacy & Terms. Tërhequr më 17 prill 2017.

https://www.google.com/policies/privacy/.

Komunikimet personale, intervistat gojore, të paregjistruara

1. Emër Mbiemër, komunikim përmes fejsbukut, 1 gusht, 2017.
2. Emër Mbiemër, komunikim përmes emailit, 1 gusht, 2017.
3. Emër Mbiemër, intervistë me autorin, 1 gusht, 2017.

Citimet nga Arkivat e vendit

Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (më tej: AQSh), Fondi: X, viti, dosja, fleta. Titulli i dosjes, Vendi, Data e dokumentit. Në citimet e mëvonshme, zërat: fondi, dosja, fleta jepen në formë të shkurtuar, pra i njëjti dokument do citohej: AQSh, F X, V_., D. _, fl. _.

Arkivat e huaja

Në citimin e dokumenteve arkivore të huaja, do t'i qëndrohet gjuhës dhe kritereve të vendit përkatës. Shëmbull, citimi i parë i plotë: The National Archives (më tej: TNA), Public Record Office, Foreign Office 371/18339. Sir R. Hodgson to Sir John Simon, Durrës, 24 January 1934.
Citimi i mëtejshëm i shkurtuar: TNA, FO 371/18339. Sir R. Hodgson to Sir John Simon, Durrës, 24 January 1934.